REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE SHOQËROR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 10/1 prot. Tiranë, më 06/01 2025

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 4, datë 06.01.2025

Në zbatim ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", si dhe VKM nr. 637, datë 27.10.2021 "*Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror*" si dhe udhëzimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores "Për mbrojtjen e të dhënave personale në Regjistrin e Profesionistëve të ASCK", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri, i cili është pjesë përbërëse e tij.
2. Caktimin e-znj. Eda Koçiaj, me pozicion specialist/jurist Sektori i Burimeve Njerëzore, Prokurimeve dhe Administrimit si Nëpunës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (VNMD) të ASCK, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 124/2024.
3. VNMD, sipas nenit 34 të ligjit nr. 124/2024, ka këto detyra:
   a) informon dhe këshillon Drejtorin e Përgjithshëm dhe punonjësit për detyrimet që rrjedhin nga ligji dhe nga Rregullorja;
   b) monitoron zbatimin e Rregullores dhe të ligjit në Regjistrin e Profesionistëve;
   c) jep mendim për vlerësimin e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, kur kërkohet;
   d) trajton kërkesat e profesionistëve për ushtrimin e të drejtave të tyre;
   e) koordinon trajtimin e incidenteve dhe mban regjistrin e tyre;
   f) bashkëpunon me Komisionerin dhe është pika e kontaktit me të.
4. VNMD ushtron detyrat në mënyrë të pavarur dhe raporton drejtpërdrejt te Drejtori i Përgjithshëm. Atij nuk i ngarkohen detyra që krijojnë konflikt interesi dhe i sigurohen aksesi dhe burimet e nevojshme për kryerjen e detyrës.
5. Të dhënat e kontaktit të VNMD-së publikohen në faqen zyrtare të ASCK dhe i njoftohen Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
6. Brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, VNMD, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për certifikimin dhe edukimin në vazhdim:

a) përfshin Regjistrin e Profesionistëve në regjistrin e veprimtarive të përpunimit;

b) harton njoftimin për privatësinë për profesionistët dhe e publikon në faqen zyrtare dhe në formularin e aplikimit;

c) rishikon të drejtat e aksesit në regjistër dhe organizon trajnimin e punonjësve që kanë akses.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen VNMD, struktura përgjegjëse për certifikimin dhe edukimin në vazhdim dhe të gjithë punonjësit e ASCK që kanë akses në Regjistrin e Profesionistëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Denis Gjika

RREGULLORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË REGJISTRIN E PROFESIONISTËVE TË ASCK

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror (ASCK)

Në mbështetje të VKM nr. 637, datë 27.10.2021, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror", kreu III, pika 3, shkronjat "j" dhe "k", dhe pika 4, si dhe të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale në Regjistrin e Profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe shoqëror, që ASCK administron për të kryer dy detyra që i jep VKM nr. 637/2021:

1. njohjen dhe regjistrimin e krediteve të edukimit në vazhdim të profesionistëve
2. procesin e certifikimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe shoqëror

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Rregullorja zbatohet për çdo përpunim të të dhënave në regjistër, elektronik ose në letër, përfshirë aplikimet nëpërmjet portalit "e-Albania".
2. Ajo detyron punonjësit e ASCK që kanë akses në regjistër dhe çdo përpunues që punon me të për llogari të ASCK.

Neni 3

Kontrolluesi dhe baza ligjore

1. ASCK, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, është kontrollues i të dhënave në regjistër, sipas nenit 22 të ligjit nr. 124/2024.
2. Të dhënat përpunohen për përmbushjen e një detyrimi ligjor dhe të një detyre në interes publik (neni 7, shkronjat "c" dhe "d", të ligjit). Pëlqimi nuk kërkohet për regjistrimin dhe certifikimin.
3. Përpunimi respekton parimet e nenit 6 të ligjit: ligjshmëri dhe transparencë, qëllim i kufizuar, minimizim, saktësi, ruajtje e kufizuar në kohë, siguri dhe përgjegjshmëri.

Neni 4

Të dhënat në regjistër

1. Në regjistër mbahen vetëm të dhënat e nevojshme për kreditet dhe certifikimin:
   - emri, mbiemri, numri personal, datëlindja;
   - kontaktet (email, telefon);
   - profesioni, diploma, specializimi dhe numri i regjistrimit në urdhrin profesional;
   - vendi i punës;
   - aktivitetet e edukimit në vazhdim, kreditet dhe statusi i certifikimit.
2. Në regjistër nuk mblidhen të dhëna sensitive, si të dhëna shëndetësore as të dhëna që nuk lidhen me kreditet dhe certifikimin.

3. Të dhënat përdoren vetëm për këto qëllime. Ndalohet përdorimi për marketing, anketa private ose interesa personale.

Neni 5

Përgjegjësitë

1. Drejtori i Përgjithshëm, si drejtues i të gjithë veprimtarisë së Agjencisë, është përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe cakton Nëpunësin për Mbrojtjen e të Dhënave (VNMD), sipas nenit 33 të ligjit.
2. VNMD, këshillon stafin, monitoron zbatimin e rregullores, trajton kërkesat e profesionistëve dhe incidentet dhe është pika e kontaktit me Komisionerin. VNMD raporton drejtpërdrejt te Drejtori i Përgjithshëm.
3. Struktura përgjegjëse për certifikimin dhe edukimin në vazhdim administron regjistrin dhe mban të dhënat të sakta e të përditësuara.
4. AKSHI, për shërbimet në "e-Albania", dhe çdo kontraktor me akses në regjistër janë përpunues. Marrëdhënia me ta rregullohet me marrëveshje me shkrim, sipas nenit 26 të ligjit.

Neni 6

Aksesi dhe konfidencialiteti

1. Aksesi në regjistër jepet vetëm punonjësve që e kanë të nevojshëm për punën, me autorizim të drejtuesit të strukturës.
2. Aksesi rishikohet çdo 6 muaj dhe hiqet po atë ditë kur punonjësi largohet ose ndryshon detyrë.
3. Çdo person me akses ruan konfidencialitetin e të dhënave, edhe pas largimit nga ASCK

Neni 7

Masat e sigurisë

1. Cdo përdorues ka llogari personale dhe fjalëkalim të fortë; ndarja e llogarive ndalohet;
2. Sistemi mban regjistër (log) të çdo hyrjeje dhe ndryshimi, që ruhet të paktën 1 vit;
3. Të dhënat dërgohen vetëm me kanale të enkriptuara dhe me email institucional;
4. Ndalohet ruajtja e të dhënave në pajisje, USB ose llogari private dhe përdorimi i shërbimeve publike të inteligjencës artificiale për to;
5. Bëhen kopje rezervë të rregullta dhe të sigurta;
6. Dokumentet në letër mbahen në dollapë që mbyllen me çelës.

Para çdo ndryshimi të madh të sistemit të regjistrit bëhet vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave.

Neni 8

Publikimi dhe dërgimi i të dhënave

1. Kur publikimi lejohet me ligj, publikohen vetëm emri, mbiemri, profesioni dhe statusi i certifikimit.
2. Të dhënat u jepen institucioneve të tjera (Ministria, urdhrat profesionalë, inspektoratet, prokuroria, gjykata) vetëm me bazë ligjore dhe kërkesë zyrtare, në masën e nevojshme.
3. Çdo dërgim te palë të treta regjistrohet.

Neni 9

Të drejtat e profesionistëve

1. ASCK informon profesionistët në formularin e aplikimit dhe në faqen zyrtare për përdorimin e të dhënave të tyre.
2. Profesionistët kanë të drejtë të shohin, të korrigjojnë ose të kërkojnë kufizimin e të dhënave të tyre.
3. Kërkesa bëhet me shkrim, në protokoll ose në email-in e VNMD-së. ASCK përgjigjet brenda 30 ditëve; ky afat mund të zgjatet deri në 60 ditë, duke e arsyetuar zgjatjen brenda 30 ditëve të para.
4. Fshirja nuk zbatohet për të dhënat që ASCK detyrohet t'i ruajë për kreditet dhe certifikimin.

Neni 10

Ruajtja dhe regjistri i përpunimeve

1. Të dhënat ruhen për kohën që profesionisti është në regjistër dhe më pas për afatin e Listës së afateve të ruajtjes së ASCK. Pas afatit fshihen ose dorëzohen në arkivë, me procesverbal.
2. VNMD e përfshin regjistrin e profesionistëve në regjistrin e veprimtarive të përpunimit, sipas nenit 27 të ligjit.

Neni 11

Incidentet

1. Çdo punonjës që vëren akses të paautorizuar, humbje të dhënash ose email të dërguar gabim njofton menjëherë drejtuesin dhe VNMD-në.
2. VNMD merr masa për kufizimin e dëmit dhe e regjistron incidentin.
3. ASCK njofton Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale sa më shpejt dhe jo më vonë se 72 orë nga marrja dijeni (neni 29 i ligjit). Kur rreziku është i lartë, njoftohen edhe profesionistët e prekur.

Neni 12

Dispozita të fundit

1. Shkelja e kësaj rregulloreje përbën shkelje disiplinore, pa cenuar përgjegjësinë civile ose penale.
2. Punonjësit me akses në regjistër trajnohen për këtë rregullore një herë në vit.
3. Rregullorja rishikohet çdo 2 vjet ose kur ndryshon legjislacioni.
4. Rregullorja hyn në fuqi me miratimin nga Drejtori i Përgjithshëm dhe publikohet në faqen zyrtare të ASCK.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
DENIS GJIKA